

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar kundër z. Salih Mustafa

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Mbrojtja

Data: 5 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime të Mbrojtjes
për konferencën mbi ecurinë e çështjes që do të mbahet më 5 tetor 2020

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Z. Xhek Smith

Mbrojtësi për të akuzuarin
Z. Julius von Bone

I. Agjenda e konferencës për ecurinë e çështjes

1. Mbrojtja ka marrë shënim përmbajtjen e Urdhrit që cakton datën për konferencën mbi ecurinë e çështjes dhe të shtojcës 1 të saj, që do të mbahet më 5 tetor 2020. Në veçanti, Mbrojtja ka marrë shënim materialin që do të nxirret nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), dhe afatet për nxjerrjen e tij.
2. Faktikisht, Mbrojtja ka marrë një numër dokumentesh në disa nxjerrje të informacionit dhe do të dëshironte të bënte disa komente në lidhje me to, mundësisht në seancë të mbyllur.
3. Në këtë fazë, Mbrojtja nuk ofron njoftim për alibi ose ndonjë arsye të përjashtimit të përgjegjësisë penale, por dëshiron që ta ruajë këtë për një moment më të vonshëm gjatë procesit.

II. Informacion për hetimet e Mbrojtjes

4. Në këtë moment, është vështirë të jepet ndonjë informacion për kohën që i nevojitet Mbrojtjes për kryerjen e hetimeve të veta. Është e sigurt se do të kryhen hetime, dhe Mbrojtja do të japë njoftim sapo të ketë një vlerësim konkret. Në këtë fazë, është shumë herët për një vlerësim të tillë, posaçërisht për arsyen se është vështirë të parashikohen rrethanat me COVID-19 dhe si do të zhvillohen ato në zonën e hetimeve.

III. Parashtrimet e ZPS-së për sistemin e redaktimeve

5. Në përgjithësi, Mbrojtja nuk ka vërejtje të veçanta në lidhje me propozimet e ZPS-së për sistemin e redaktimeve. Meqenëse sistemi do të zbatohet *mutatis mutandis* për Mbrojtjen, Mbrojtja beson se mund të zbatohet sistemi i redaktimeve që është propozuar.
6. Sidoqoftë, është një gjë që të dy palët duhet ta kenë parasysh.
7. Palët duhet të jenë të vetëdijshme se mund të ndodhë që edhe ZPS-ja edhe Mbrojtja të kontaktojnë të njëjtin dëshmitar, qoftë ai dëshmitar material apo dëshmitar ekspert, ose burim që zbulon informata në lidhje me një çështje, ngjarje,

incident apo çfarëdo qoftë. Në raste të tilla, edhe nëse bëhet fjalë për dëshmitar të mbrojtur, do të ishte e dobishme që të kemi një mënyrë veprimi.

8. Kjo mund t'i ndodhë edhe ZPS-së edhe Mbrojtjes. Mbrojtja beson se kjo mund të ndodhë kur hetimet e të dy palëve janë në kryerje e sipër, por mund të ndodhë edhe pas përfundimit të tyre.

9. Mbrojtja ka bindjen se asnjëra palë nuk mund të ketë, ose të pretendojë, pozitë monopoli sa u përket dëshmitarëve, ekspertëve apo çfarëdo personi tjetër që mund të jetë relevant për cilëndo palë. Kjo duhet të vlejë edhe për burimet që zbulojnë të dhëna shkresore ose raporte.

10. Nëse kjo do të kishte ndonjë pasojë për sistemin e redaktimeve, p.sh. që të përdoret i njëjti pseudonim, atëherë Mbrojtja do të pajtohej me atë. Çfarëdo mënyre tjetër do të ishte gjithashtu në rregull. Nuk ndodh shpesh, por gjatë hetimeve (të të dyja palëve), është teorikisht e mundshme, dhe për këtë arsye duhet ta kemi parasysh dhe më mirë ta diskutojmë tani se në fazat e mëvonshme të procesit.

11. Sidoqoftë, nëse ndodh kjo, interesat e dëshmitarëve, ekspertëve dhe/ose të familjeve të tyre përkatëse janë parësore dhe duhet të mbrohen në mënyrë të duhur me qëllim që të gjithë ata të jenë të qetë për sigurinë e vet.

12. Mbrojtja nuk ka vërejtje të tjera.

Numri i fjalëve (në origjinal): 602

/nënshkrim/

Julius von Bone

Mbrojtës i të akuzuarit

5 tetor 2020

Në Hagë, Holandë